


SHOQËRIA DEMOKRATIKE



DEMOKRACIA ËSHTË E JONA

VJOLLCA (11), MALSOR (11), VALTON (11), AMIRE (11), VLERA (11), BLEREND (11)



Të lumtur dhe të gëzuar, ju ftojmë të lexoni artikullin tonë. Ne flasim për demokracinë, rëndësinë e saj dhe rëndësinë tonë në demokraci

Ne e dijmë se të gjitha shtetet kanë një formë të udhëheqjes. E njëra nga këto forma është edhe demokracia. Kjo na bën të kuptojmë se demokracia është mënyrë e qeverisjes. Në demokraci udhëheq populli. Kjo bëhet me anë të votës në procesin zgjedhor. Gjatë këtij procesi, populli zgjedh përfaqësuesit e tij të cilët kanë për detyrë të udhëheqin shtetin.

Këta përfaqësues, nuk do ta udhëhiqnin shtetin, nëse populli nuk do t'i votonte. Siç po e shihni, populli e bën demokracinë, pasi që populli konsiderohet si shtylla kryesore e demokracisë. Nëse demokracinë e paramendojmë si një fidane, në kopshtin e jetës sonë, kjo fidane për t'u rritur ka nevojë për diell, ujë dhe dheun e duhur. Të gjitha këto elemente, jemi ne ata të cilët mund t'ia ofrojmë kësaj fidaneje. Në momentin që rritet kjo fidane, ne do të kemi një kopsht shumë të bukur. Prandaj, edhe me demokracinë, nëse e ruajmë dhe kujdesemi për të, ajo do të na sigurojë shumë të drejta e shumë gëzime.

Këto të drejta, të cilat i gëzojmë në demokraci janë: e drejta e shkollimit, e drejta e shprehjes së lirë, e drejta e identitetit, e drejta e argëtimit, etj. Megjithatë, kjo nuk është e tëra, sepse demokracia ka edhe disa elemente kryesore, siç janë: barazia, respekti, solidariteti, paqja, toleranca, etj. Ne gjithashtu mundohemi që në

përditshmëri, të jetojmë sipas këtyre elementeve. Në shkollë ne jemi tolerantë ndaj njëri-tjetrit. Në rast se jemi duke bërë ndonjë aktivitet, dhe pa dashje dikush nga ne lëndohet, ne asnjëherë nuk krijojmë konflikt, por jemi tolerantë. Ne gjithashtu tregojmë respekt ndaj të gjithëve, pa dallim moshe, feje, race, kombi apo gjendje ekonomike. Demokracia ka dy forma kryesore: demokracia përfaqësuese dhe ajo e drejtpërdrejtë. Mirëpo, edhe demokracia përfaqësuese ndahet në dy sisteme: sistemin parlamentar dhe atë presidencial. Ne kemi demokraci përfaqësuese me sistem parlamentar, sepse tek ne, Presidentin e zgjedhin deputetët. Demokracia u paraqit për herë të parë në Athinë, pra, në Greqi në vitin 507 p.e.s. Në atë kohë, të drejtë vote kishin vetëm burrat e pasur. Ndërsa, sot të gjithë kemi të drejtë të votojmë, sepse të gjithë jemi të barabartë. Kjo është demokracia jonë. Ruajeni dhe kujdesuni për të në mënyrë që ta kemi gjithmonë.




Gazetarët e këtij artikulli duke bashkëpunuar



Disa fjalë nga ne, për demokracinë




Vepra dhe puno për të ardhmen tënde



Shkolla, vendi ku ne mësojmë shumë gjëra. Këtë të drejtë na mundëson pikërisht demokracia



Ne shprehim mendimet tona



Si ka ndryshuar demokracia gjatë kohës


INSTITUCIONI LIGJVËNËS

DRENUSHA (11), ERBLINA (11), SHKËNDIJE (11), GENT U. (11), QEMAJL (11), ISMAJL (12), ALBION (12)



Ne jemi nxënësit e klasës së VI-të nga shkolla fillore „Dardania“ fshati Rakaj, Ferizaj dhe në këtë artikull të cilin e kemi përgatitur ne, mund të lexoni për Kuvendin e Kosovës

Pasi që tema jonë është Kuvendi i Kosovës, ne do të paraqesim disa fakte për këtë institucion. Në Kuvendin e Kosovës bëjnë pjesë 120 deputetë.



Një vizatim i Kuvendit të Kosovës

Këta deputetë zgjedhen nga populli i Kosovës. 100 prej tyre janë shqiptarë, ndërsa 20 të tjerë janë nga komunitete jo shumicë. Ata janë deputetë ashkalinjë, serbë, egjiptianë, boshnjakë, etj. Të gjithë këta deputetë përfaqësojnë qytetarët e Kosovës. Prandaj, për Kuvendin e Kosovës themi se ka funksion përfaqësues. Deputetët së pari zgjedhin Kryetarin e Kuvendit. Më pastaj, ata zgjedhin Kryeministrin, i cili zgjedh ministrat të cilët do të punojnë në Qeveri. Ligjet janë

regulla të shkruara, të cilat ekzistojnë për të na bërë jetën tonë më të mirë dhe më të lehtë. Institucioni që është përgjegjës për të nxjerrë dhe për të miratuar ligjet është Kuvendi. Pikërisht ky është funksioni tjetër i Kuvendit, i cili është funksioni legjislativ. Të gjitha ligjet që miratohen duhet të përputhen me Kushtetutën e Kosovës. Ndërsa, secili ligj ka nenet e veta.

Funksioni i fundit i Kuvendit të Kosovës është funksioni i kontrollit. Kjo do të thotë se Kuvendi kontrollon Qeverinë, duke iu bërë pyetje ministrave dhe Kryeministrit. Këto quhen pyetje parlamentare dhe është detyrë e deputetëve që t'i bëjnë këto pyetje.

Ne mendojmë se demokracia nuk mund të ekzistojë pa një institucion i cili nxjerr ligje. Ligjet, të cilat flasin për respektimin e të drejtave të njeriut të miratuara nga Kuvendi, janë disa nga ligjet që na lehtësojnë jetën tonë dhe na mundësojnë të jetojmë në një demokraci më të plotë.



Ne jemi e ardhmja e vendit tonë

ZGJEDHJA ËSHTË E POPULLIT

EDISON (12), LEOTRIM (11), SHQIPRIM (12), REVAJETE (11), BESNIK (12), GENTA (11), GENT A. (11)

Për të mësuar më shumë për zgjedhjet në demokraci, lexojeni këtë artikull

Ne sot në grupin tonë kemi diskutuar për zgjedhjet dhe rëndësinë e votës në demokraci. Populli në zgjedhje voton përfaqësuesit e tij. Kemi dy lloje të zgjedhjeve: zgjedhjet komunale dhe zgjedhjet parlamentare. Zgjedhjet komunale janë kur qytetarët votojnë kandidatët për kryetar të komunës dhe asambleistët, kurse zgjedhjet parlamentare janë kur populli voton kandidatët për deputetë. Në Kuvend, deputetët votojnë kandidatët për President dhe e zgjedhin atë.

Të drejtën e votimit në procesin zgjedhor e kanë ata qytetarë të cilët janë mbi moshën 18 vjeçare, sepse janë më të pjekur dhe e dijnë se për kë votojnë. Në këtë moshë edhe ne do ta kemi këtë të drejtë. Edhe pse jemi të lirë dhe i kemi të drejtat e barabarta, prapëseprapë ne duhet ta respektojmë njëri-tjetrin.



Grupi i demokratëve



Në këtë vizatim është paraqitur një qytetar duke pyetur për zgjedhjet



Qytetari duke treguar arsyen e votës së tij dhe se si ai e sheh ndikimin që ka në vendin ku jeton



Demokracia, udhëheqje e popullit



Ne punojmë së bashku



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:
Tel: +381 38 704 560
E-mail: info@demos-ti.org
Website: www.demos-ti.org

Pjesëmarrësit:
SHFMU „Dardania“
Klasa: VI-1
Vendi: Rakaj, Ferizaj